



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.984/ 4 prot

Datë 29.04.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 571 /2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.04.2026 me:

**Objekt:** Mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, *Mallra*, me Nr. REF-79813-03-24-2026, me objekt: Blerje Kancelari, me fond limit 1,250,000 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit sipërcituar.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK me NIPT J62426002Q. *Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Kodër Kashar, Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kukës.  
*Adresa: Sheshi Skënderbej, Lagja 5, Kukës.*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndyshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të*

*Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 25.03.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, *Mallra*, me Nr. REF-79813-03-24-2026, me objekt: Blerje Kancelari, me fond limit 1,250,000 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6470, datë 01.04.2026 dhe me nr. 984/2026 prot., datë 01.04.2026 i operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit.

II.3. Me shkresën nr. 1707 prot., datë 14.04.2026, protokolluar me tonën me Nr. 984/1 prot., datë 16.04.2026, Autoriteti Kontraktor ka përcjellë me shërbim postar Vendimin me Nr. 22/11 prot., datë 09.04.2026 të KSHA-së, duke vendosur pranim pjesërisht të pretendimeve të ankesës.

**III**

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

### Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik mbi modifikime të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumente si vijon

1. Në lidhje me hartimin e specifikimeve teknike të artikujve objekt prokurim, parashtrojmë kundërshtimet tona si më poshtë vijojnë:

Nr.	Emërtimi	Specifikime teknike	Pretendime te operatorit ekonomik
6	Dosje me buton 10 cm	<b>Dosje me buton 10 cm/ dosje me buton 15 cm-</b> dosje për arkivimin dhe ruajtjen e dokumenteve, e pajisur me sistem mbylljeje me buton dhe <b>litar elastic</b>	<b><i>Të hiqet: togfjaleshi dhe litar elastic, sepse Dosje me buton nuk kanë litar elastic.</i></b>
12	Kapëse letrash gjarpërueshe të madhesive ndryshme (paper clip)	<b>Kapëse letrash gjarpërueshe të madhesive ndryshme (paper clip)</b> Kapëse aktesh metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumentave. Kërkohej që madhesia e tyre të jete e ndryshme duke përfshirë 25 mm, 28 mm, 33 mm dhe 50 mm.  Nga <b>250 cp per secilën madhësi.</b>	<i>Tek formulari sasise jane percaktuar 300 pako nderkohe eshte kerkuar 250 cp per secilën madhësi.</i>  <b><i>Korigjoni dhe saktësoni sasinë e kërkuar për këtë artikull sipas madhësive të kërkuara tek specifikimet teknike.</i></b>
13	Kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18)	<b>Kuti per ruajtje te perhershme-</b>  Të ketë përmasa 18 x 28.5 x 40.5 cm, material kartoni i fortë dhe i trashë, me kapak. (deri në 5% marzh gabimi).	<b><i>Kërkojmë të ndryshohet përshkrimi këtij artikulli pasi artikulli Dosje per ruajtje te perhershme, nuk lejohet te prokurohen nga vetë institucionet Me VKM-në nr.360, datë 26. 04. 2017, Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Dr. së Përgjithshme të Arkivave ndryshuar me VKM nr. 608, datë 22.09.2022, përcaktohet se:Dr. e Përgjithshme e Arkivave kryen blerjen e përqendruar për të gjitha autoritetet dhe entet kontraktore për kuti dhe dosje të standardit të përhershëm, dhe etiketat e tyre.</i></b>
17	Letër format A4 ,80 r/m <sup>2</sup>	<b>Leter format A4 ,80 gr/m2</b> Çilesi e pare me çertificate ISO. Përmasa 210x297, , Amballazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 risma. Përdorimi për fotokopje dhe	<b><i>Te Hiqen percaktimet dhe parametrat:</i></b> <i>Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin.</i> <i>Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit.</i>

		<p>printim. Lagështia:3.5-4.5% Trashësia:103-110 µm. Lëmueshmëria: 80-100 ml/min Aftësia në përkulje: &gt;110mN DM Ashpërsia në përkulje: &gt;54nm CD Dukshmëria:&gt;94% Shkëlqimi:101-104%.CIE Bardhësia:148-152. Letra të mos bllokohet makinën fotokopjuese apo printerin. Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit. Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit. Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët. Të plotësojë standartet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë. Të mos jetë e ricikluar</p>	<p><i>Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët..</i> <i>Të mos jetë e ricikluar,</i> <i>Aftësia në përkulje: &gt;110mN DM</i> <i>Ashpërsia në përkulje: &gt;54nm CD</i></p> <p><b><i>Te hapet Diapazoni për:</i></b> <i>Lemueshmeria:80-100 ml/min bëhet</i> <i>Lemueshmeria:80-130ml/min;</i> <i>Shkelqimi:101-104%, të bëhet:</i> <i>Shkëlqimi:101-115%;</i> <i>CIE bardhësia: 148-152, të bëhet:</i> <i>CIE bardhësia: 148-170</i></p>
27	DVD	<p><b>DVD-</b> Disqet optike sigurojnë ruajtje të sigurt dhe afatgjatë të skedarëve dhe dokumenteve të rëndësishëm, ideale për të gjitha fotot dhe videot. Me shpejtësi 16x dhe kapacitet regjistrimi 4.7 GB, deri në dy orë video në një disk DVD-R. Të jetë rezistent ndaj pluhurave dhe ndaj ujit, gjithashtu duhet t'i rezistojnë ndryshimeve në temperaturë dhe lagështi. Paketimet duhet të jenë të dobishëm dhe bobinë mbrojtëse ndaj prekjeve për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e disqeve. Të jenë në paketim bobinë me 10 copë.</p>	<p><i>Kërkojmë që të saktësohet dhe të qartësohet nëse kërkohen 35 cope bobina me nga 10 cope që në total bejne 350 DVD apo vetem</i></p> <p><i>35 cope DVD, pasi njesia matëse për këtë artikull nga AK-ja është përcaktuar cope dhe jo bobine .</i> <b><i>Lutemi bëni saktësimet e nevojshme.</i></b></p>

III.1.1. Autoriteti Kontraktor me Vendimin me Nr. 22/11 prot., datë 09.04.2026 të KSHA-së, duke vendosur pranim pjesërisht të pretendimeve të ankesës e konkretisht mbi modifikimin e specifikimeve teknike të artikujve sipërcituar objekt ankimi, me argumentim të vendimit:

*[...]Në shqyrtim të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik konstatohet se pretendimet lidhur me specifikimet teknike janë të bazuara. Për rrjedhojë pretendime lidhur me specifikimet teknike pranohen dhe konsiderohen të arsyeshme dhe do të merren parasysh për përditësim/ndryshimin përkatës të dokumenteve të tenderit.*

*Për këto arsye KSHA vendos të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik. [...]*

III.1.2. Referuar Nenit 30 i Ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje*

janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

Neni 115 pika 1 dhe 3 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se:

*Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

*3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:*

*a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;*

*b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”*

III.1.3. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik si edhe Vendimit të KSHA-së, mbi pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni do të mbyllë shqyrtimin e pjesës së pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Mallra, me Nr. REF-79813-03-24-2026, me objekt: Blerje Kancelari, me fond limit 1,250,000 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.

Komisioni do të vijojë me shqyrtimin në themel të pretendimeve të tjera të ngritura në ankesë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik mbi modifikime të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumente si vijon:

*Në lidhje me afatet e levrimit të përcaktuara tek njoftimi i kontratës dhe tek shtojca 7 (FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT) të DT-së ku është përcaktuar: Afatet e levrimit:15 (pesëmbëdhjetë) nga data e nënshkrimit të kontratës. parashitjet kundërshtimet tona si më poshtë vijnë: Afati i levrimit të mallrave objekt kontrate vetëm 15 ditë, i përcaktuar nga AK është një afat i shkurtër dhe jo në proporcion me volumin dhe*

natyrën e kontratës, i pa argumentuar nga autoriteti kontraktor dhe që sjell vështirësi për operatorët ekonomike për tu përmbushur, duke u bërë shkak për aplikimin e penalteteve në rast të lëvrimit të mallrave përtej afatit 15 dt nga lidhja e kontratës. Në procesverbalin e hartimit të dokumentave të tenderit, nga njësia e prokurimit nuk ka asnjë argumentim në lidhje me vendosjen e këtij afati prej vetëm 15 dt. Nuk është përcaktuar asnjë argument se përse për AK-në është kaq e rëndësishme që i gjithë malli objekt kontrate të lëvrohet brenda 15 ditëve. Për pasojë ky afat kaq i shkurtër i pa argumentuar nga AK-ja është abuziv dhe kufizon pjesmarrjen e OE-ve në këtë procedurë prokurimi. Mallrat objekt prokurimi janë mallra kryesisht importi, të cilat nuk prodhohen në vend dhe në cdo rast pavarësisht se, OE duhet të ofertojnë në tender duhet të kenë bashkëpunime me prodhuesit e këtyre produkteve, dhe duhet një kohë më e gjatë në dispozicion për porositje, koha e transportit dhe zhdoganimit të mallrave. AK, nuk mund të vendosë kërkesa të pa argumentuara, jo në proporcion me objektin e prokurimit, pasi nuk mundësojnë pjesmarrjen e OE-ve në këtë procedurë. Është në detyrimin e AK-së të respektojë dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, të garantojë respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara rregullat e prokurimit publik.

**Ky afat kaq i shkurtër vjen në kundërshtim me parimet dhe qëllimin e ligjit të prokurimit publik e të përcaktura në nenin 2 dhe nenin 3 të LPP.**

**Për gjithë sa më sipër, kërkojmë që afati i lëvrimit të mallit të ndryshojë dhe të bëhet të paktën 30 ditë nga lidhja e kontratës.**

III.2.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në DST Shtojcën 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

#### “Blerje kancelarie”

Sasia e mallit që kërkohet:

**Afatet e lëvrimit:** 15 (pesëmbëdhjetë) nga data e nënshkrimit të kontratës.

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Bllaqe te verdha 75*75 mm	Copë	125
2	Kalkulator 16 digit	Copë	5
3	Leter index, me ngjites, me ngjyra te ndryshme (50mm x 15 mm) Ndarëse letre me 4 ngjyra, me ngjitje (Sticky notes)	Pako	100
4	Çantë dhuratash e vogel (30 cm x 25 cm), ngjyre qumeshti me logon e bashkise Kukës	Copë	15
5	Çantë dhuratash e madhe (50 cmx 45 cm), ngjyre qumeshti me logon e bashkise Kukës	Copë	15
6	Dosje me buton 10 cm	Copë	50
7	Dosje me buton 15 cm	Copë	30
8	Dosje kartoni me titull	Copë	2350
9	Dosje me llastik 6 cm	Copë	70
10	Dosje kartoni me llastik 2cm	Copë	150
11	Dosje me mekanizem	Copë	100

12	Kapese letrash gjarperueshe te madhesive ndryshme (paper clip)	Pako	300
13	Kuti per ruajtje te perhershme (40x28x18)	Cope	50
14	Kapese aktesh me veshe 25 mm	Pako	50
15	<sup>1</sup> Liber protokolli aktesh	Copë	25
16	Korrektor stilo metal 7ml	Copë	70
17	Leter format A4 ,80 gr/m2	Rizma	2450
18	Makine kapese aktesh deri 30 flete, staples 24/6	Copë	50
19	<sup>2</sup> Liber dorzimi	Copë	5
20	Thumba per kapese 24/6 (1000 pcs)	Pako	150
21	Ngjites Stick, 21gr	Copë	50
22	Marker me ngjyre (shenues paragrafesh)	Copë	30
23	Zarfa letre të mëdhenj A3	Copë	50
24	Zafra te vegjel, te gjate (me ngjites)	Copë	3500
25	Zarfa A4	Copë	1613
26	Leter A3	Rizma	8
27	DVD	Copë	35
28	USB 32 GB	Copë	12
29	USB 64 GB	Copë	12
30	Lapsa(pako 12 copa)	Pako	15
31	Stilolapsa	Copë	300
32	Goma fshirese lapsash	Copë	30
33	Mbajtese Kancelarie per mjete	Copë	5
34	Mbajtese dokumentesh horizontale	Copë	5
35	Karton A4, 270gr	Rizme	2
36	Bateri Litiumi CR2032	Copë	10
37	Bateri Litiumi CR2025	Copë	10

III.2.2. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, thuhet se: “1.Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Referuar nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik”,i ndryshuar:-“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti

*kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”*

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret për kualifikim dhe kërkesat për operatorët ekonomikë vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, duhet të vërtetojnë se zotërojnë aftësitë teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses në kohë dhe me cilësi të kontratës në një procedurë prokurimi. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim dhe kërkesat e tenderit gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, në përpjesëtim me objektin, sasinë dhe natyrën e kontratës së prokurimit, mallrave.

III.2.4. Në rastin konkret, referuar pretendimit të ankimuesit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit, në shtojcën 7, Formularin e sasisë së artikujve dhe grafikun e lëvrimit, duke përcaktuar afatin e lëvrimit nga lidhja e kontratës **15 ditë**. Pretendimet e operatorit ekonomik janë argumentuar për modifikim deri 30 ditë të afatit të lëvrimit të mallrave me argumente: *[...]Mallrat objekt prokurimi janë mallra kryesisht importi, të cilat nuk prodhohen në vend dhe në cdo rast pavarësisht se, operatorët ekonomikë që do të ofertojnë në këtë tender duhet të kenë bashkëpunime me prodhuesit e këtyre produkteve, nevojitet një kohë më e gjatë për OE që lidhet me porositjen, transportin nga prodhuesi tek OE i shpallur fitues, por edhe koha e zhdoganimit të mallrave në pikat doganore. [...]*

KSHA me Vendimin, mbi trajtimin e ankesës, nuk ka pranuar të modifikojë afatin e lëvrimit të mallit, duke argumentuar se: *[...] AK ka mungesa të materialeve per kancelari për administratën dhe kërkojmë furnizim të shpejtë... artikujt janë lehtësisht të disponueshëm në treg dhe ka subjekte që e realizojnë në kohë furnizimin me artikujt e kërkuar [...].*

Referuar Proces verbalit të argumentimit të kriterëve për kualifikim Komisioni konstatoi se AK nuk ka argumentuar vendosjen e afatit të lëvrimit të mallrave objekt prokurimi.

Komisioni mori në shqyrtim dokumentet e procedurës së prokurimit, argumenteve të ankimuesit si edhe në analizë të Shtojcës 7, Formuari i sasisë dhe Grafiku i lëvrimit e konkretisht të sasisë së artikujve të kërkuar të cilët janë në numër të konsiderueshëm dhe në referim të testit të proporcionalitetit gjykon, se afati i lëvrimit të mallit në rastin konkret, duhet të jetë më i gjatë, në përputhje me volumin dhe përmasat e kontratës, në mënyrë që ofertuesve t’ju lihet koha e nevojshme për të siguruar në kohë mallrat, me karakteristikat dhe specifikimet e kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Përsa argumentuar më sipër Komisioni gjykon që autoriteti kontraktor duhet të modifikojë afatin e lëvrimit të mallit, në mënyrë të tillë që të nxisë pjesëmarrjen dhe konkurrencën e

operatorëve ekonomikë, të stimulojë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në këto procedura, për realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndyshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar nga autoriteti kontraktor të ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Mallra, me Nr. REF-79813-03-24-2026, me objekt: Blerje Kancelari, me fond limit 1,250,000 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.
2. Të pranojë pjesërisht pretendimet e ankesës për procedurën e prokurimit sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e procedurës së prokurimit sipas Vendimit të KSHA-së dhe konstatimeve të këtij Vendimi me publikimin e shtojcës përkatëse.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP-në mbi zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Gjergj Mersini**

**Anëtar**

**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**

**Fiorent Zguro**

